
PROJECT MANAGEMENT AND DEVELOPMENT

Baki KoleciUniversity „Haxhi Zeka” Peja Kosovo baki.koleci@hotmail.com**Rina Koleci**University of Prishtina “Hasan Prishtina” Prishtina Kosovo kolecirina@gmail.com

Abstract: Determinant systems - are systems in which the state of the system can be fully identified at any time even if the implementation of a specific control act or entry leads to a false state, which can be foreseen, then such a system is defined. Namely, the determinant system is a system whose behavior is fully known. Such systems consist of the elements between which precisely defined links exist, and their interconnections are known, so that when we know the prior state and the information processing algorithm we can predict the following state of the system. Governance with defined systems implies the existence of a specific purpose and criterion of governance. With these systems we mean real-material systems that exist in a given environment. Once determined, the timing breaks down to a small or large extent, depending on the changing environment, just as under the influence and influence of the system itself. There is no 100% defined system for this. Stochastic systems - are those in which the application of the controlling or influential action of inputs to the system transforms the known state of the system into one possible state, but not the only action. Stochastic meaning is the opposite of determination. Stochastic meaning is used when we want to mark phenomena (processes) which do not perform according to the prescribed law but contain a random character. Their prediction is based on false probability experience. In the stochastic set of systems belong composite systems, hence systems consisting of a large number of interconnected elements. Often with stochastic systems we refer to systems that cannot be described accurately in the language of mathematics either because the system has a large number of related elements unknown to us or because we know enough about the nature of the phenomena that occur in the system itself, and therefore we cannot quantitatively describe them. Systems with stochastic behavior are thought of as systems where processes and changes in them are driven by insufficient causes for us. To govern these systems we need to know the probability of the origin of the particular state of the system in which they can be found after the implementation of the particular action (experiments). Equilibrium - is once and for all the right condition. When the system sets a state of equilibrium, then it tends to contain that state regardless of the circumstances that prevail in the surroundings. If the system with external or internal impact is removed from the equilibrium state and if it returns to equilibrium state even after the effects of those triggers are stopped, then it is a stable system. The stable system has the specified equilibrium time and does not change location and condition without the influence of external forces. Labile system - after exerting force from outside it returns to the previous state again with the help of another force. The system with large entropy does not return on its own. Label system processes usually progress and we stop them as needed. Indifferent systems - take the position and remain in it depending on the force acting on it.

Keywords: deterministic systems, system governance, stochastic meaning.

MENAXHIMI DHE ZHVILLIMI I PROJEKTEVE**Baki Koleci**University „Haxhi Zeka” Peja Kosovo baki.koleci@hotmail.com**Rina Koleci**University of Prishtina “Hasan Prishtina” Prishtina Kosovo kolecirina@gmail.com

Abstrakt: Sistemet determinante (të përcaktuara) - janë sisteme tek e cila në çdo moment në tërësi mund të identifikohet gjendja e sistemit edhe nëse zbatimi i aktit kontrollues të caktuar ose hyrja sjell deri në gjendjen e rre, e cila mund të parashikohet, atëherë sistemi i tillë është i përcaktuar. Përkatesisht sistemi determinant është sistem sjellja e të cilit është e njohur plotësisht. Sistemet e tillë janë të përbërë prej elementeve ndërmjet të cilit ekzistojnë pikërisht lidhjet e përcaktuara, a mesndikimet e tyre i kemi të njohura, ashtu që kur e kemi të njohur gjendjen paraprake dhe algoritmin e përpunimit të informacionit mund ta parashikojmë gjendjen vijuese të sistemit. Qeverisja me sistemet e përcaktuara nënkupton ekzistimin e synimit të caktuar dhe kriteriumit të qeverisjes. Me këto sisteme mendojmë në sisteme reale-materiale të cilat ekzistojnë në rrethinën e caktuar. Njëherë përcaktimi i vendosur, me kohë prishet në masë të vogël ose të madhe, në varshmëri prej ndryshimit të rrethinës, ashtu si nën ndikimit e influences e vet sistemit. Për këtë nuk ekziston 100% sistem i përcaktuar. Sistemet stohastike – janë ata tek të cilat

zbatimi i veprimit kontrollues ose influencës e madhësive hyrëse në sistem transformohet gjendja e njohur e sistemit në njëren gjendje të mundëshme, por jo në veprimin e vetëm. Kuptimi stohastik është e kundërta e determinimit. Kuptimin stohastik përdorim kur duam që të shënjesojmë dukuritë (proceset) të cilat nuk realizojnë sipas ligjit të paraparë të përcaktuar, por në vete përmban karakterin e rastësishme. Parashikimi i tyre kryhet në bazë të përvojës së rre – probabilitetit. Në grupin stohastik të sistemeve përkasin sistemet e përbëra, prandaj sistemet të cilat përbehen prej numrit të madh të elementeve të lidhura mes vete. Shpeshherë me sistemet stohastike quajmë sistemet të cilat nuk është e mundëshme të përshkruhet saktësisht në gjuhën e matematikës qoftë se sepse sistemi ka numër të madh të elementeve të lidhura mes veti për ne në mënyrë të panjohur ose sepse se njohim mjaft natyrë e dukurive të cilat ndodhin në vetë sistemin, dhe prandaj nuk mundim ti përshkruajmë kvantitativisht. Pë sistemet me sjelljen stohastike mendohet në sistemet tek të cilat proceset dhe ndryshimet në ta ecin prej shkaqeve jo të mjaftueshme për ne. Për qeverisjen me këto sisteme përkushtimisht duhet të njohim probabilitetin e zanafillës së gjendjes të caktuar të sistemit, në të cilën mund të gjenden pas zbatimit të veprimit të caktuar (eksperimenta).

Gjendja e baraspeshës- është njëherë dhe përfundimisht gjendja e duhur. Kur sistemi vendos gjendje e baraspeshës, ather ajo tenton që atë gjendje përmbaj pa mar parasysht rrethanat të cilat mbizotërojnë në rrethinë. Nëse sistemi me ndikimin e jashtë ose mbrendshëm nxirret prej gjendjes së baraspeshës dhe nëse edhe pas ndalimit të ndikimeve të atyre shkatarrëve përsëri kthehet në gjendjen e baraspeshës, atëherë ajo është sistem stabil. Sistemi stabil ka kohën e caktuar të baraspeshës dhe nuk ndryshon vendndodhjen dhe gjendjen pa ndikimin e forcave prej jashtë. Sistemi labil - pas ndikimit të forcës prej jashtë kthehet në gjendjen e mëparshme përsëri me ndihmën e ndonjë force tjetër. Sistemi me entropi të madhe nuk kthehet vetë. Proceset e sistemit labil zakonisht përparojnë edhe ne sipas nevojës i ndalojmë. Sistemet indiferente – marrin pozitën dhe mbesin n dhe mbesin në të në varshmëri prej force e cila në të ka vepruar.

Fjalët kyçe: Sistemet determinante, qeverisjet me sistem, kuptimi stohastik.

1. HYRJE

Menaxhimi i Projekteve ofron njohuri teorike dhe praktike mbi projektet dhe i aftëson studentët për udhëheqje menaxheriale me projektet. Materiali që trajtohet në kontinuitet bazohet në programet e një numër Universitetesh të ndryshme. Në vazhdim do të jepen kuptimet themelore mbi projektin, dimensionet e projektit, personin i cili quhet menaxher i projektit dhe rolin e tij, karakteristikat e një projekti, fazat e ciklit të projektit, hartimin e projektit, menaxhimin me kohëzgjatje, koston por edhe të performancën e projektit, menaxhimin e rrezikut dhe vlerësimin e financave në projekt. Projektet janë aktivitete të kufizuara kohore me qëllim dhe me resurse në dispozicion të përcaktuara qartësisht. Në material janë bërë përpjekje që konceptet, ilustrimet si dhe pjesë të tjera të jenë sa më të përshtatshme dhe të vlefshme. Menaxhimi i projektit paraqet një metodë për të realizuar të gjitha synimet dhe objektivat kryesore të një plani. Zakonisht plani është i zbërthyer dhe i detajuar, ndërsa menaxhimi i projektit kryhet drejtpërdrejt.

Projekti në të shumtën e rasteve mund të përshkruhet thjeshtë duke e paraqitur si përgjigje të një nevoje dhe zgjidhje e një problemi. Zakonisht projekti paraqet një zgjidhje që mundëson përfitim, financiar apo edhe tjetër. Ekzistojnë disa aktivitete që quhen projekte, por në të vërtetë nuk janë projekte! Në anën tjetër, disa aktivitete të cilat nuk përjetojnë si projekte por mund të organizohen dhe udhëheqen si projekte. Definicioni më i përdorur për projektin është: Projekti paraqet një aktivitet në të cilin janë të përcaktuara paraprakisht: qëllimi i qartë dhe i realizueshëm, kohëzgjatja e fundme e projektit, resurset e projektit (njerëzit, koha, mjetet financiare) si dhe niveli i dëshiruar se çfarë pritet të jetë produkti final. Klasifikimi i aktiviteteve të kryera brenda një kompanie mund të ndahet në dy aktivitete të mëdha, në aktivitetet operative dhe ato sipërmarrëse. Përderisa aktivitetet operative janë të tanishme dhe të përsëritshme, aktivitetet sipërmarrëse të llojit të projekteve janë të papërsëritshme dhe unike. Fjalën “projekt” si term e përdorim dhe e dëgjojmë shpesh në jetën tonë të përditshme por jo të gjithë e dinë kuptimin e saktë të kësaj fjale. Projekti në kuptim të përgjithshëm paraqet një përpjekje për të prodhuar ose për të krijuar një produkt apo shërbim kualitativ brenda një kohe të caktuar dhe çmimi të caktuar. Për fjalën „projekt” ka shumë përkufizime dhe definicione të cilat janë dhënë nga studiues dhe ekspert të biznesit. Disa prej tyre, projektin e definojnë atë si: - “Një përpjekje e përkohshme e cila ndërmerret për të arritur një qëllim të caktuar”.

- “Projekti është një hap i veçantë që lejon strukturimin metodik dhe progresiv të një realiteti të ardhshëm”. - “Një organizim i njerëzve të cilët janë të përkushtuar për të arritur një qëllim të veçantë ose objektiv. Projektet përgjithësisht janë të shtrenjta, unike, me rrezikshmëri të lartë dhe të cilat duhet të përfundojë brenda një date të caktuar, për një shumë të caktuar parash dhe me një nivel të pritur të performances. Në minimum, të gjitha projektet duhet të kenë objektiva të përcaktuara mirë dhe burime të mjaftueshme për të kryer të gjitha detyrat e kërkuara”.

2. KARAKTERISTIKAT DHE LLOJET E PROJEKTEVE

Projekti është koncept i përkufizuar i sendërtimit të një qëllimi apo detyre në të cilin janë përcaktuar teknologjia, resurset dhe terminet kohore të kryerjes së aktiviteteve të ndërlidhura. Prandaj mund të thuhet se projekti paraqet algoritmin e arritjes së qëllimeve të parashtruara nëpërmjet qeverisjes. Prej karakteristikave që e përkufizojnë projektin duhet përmendur:

- Qëllimi i cili sendërtohet nëpërmjet realizimit të detyrës së përcaktuar, - Projekti nuk përsëritet, paraqet një punë të njëkohshme, - Koha e definuar e fillimit dhe përfundimit të projekteve - Aktivitetet janë të lidhura në bazë të një logjike të teknologjisë së kryerjes së tyre. Kryerja e tyre kërkon një bashkërenditje profesionale të punëve dhe aktiviteteve. - Projekti ballafaqohet me një dozë rreziku lidhur me kryerjen e detyrave. Llojet e projekteve që mund të hasim, janë të llojeve dhe natyrave të ndryshme, si:

- Projekte shkencore kërkimore, projekte mbi produkte të reja, hulumtimin e tregut, projekte mbi eksperimentet shkencore,

- Projektet e proceseve teknologjike në prodhim, projektet e pajimeve, instalimeve,

- Projektet mbi ndërtimet: ndërtesat, rrugët, urat, objektet energjetike,

- Projektet mbi personelin (përrirja, rritja e numrit të të punësuarve, projekti i aftësimin etj.)

- Projektet mbi strukturën organizative, riorganizimet dhe integrimet. Duhet të përmendët se të gjitha këto lloje të projekteve të cilat u përmenden me lartë janë të lidhura me investime dhe në shumicën e rasteve quhen si projekte investuese pasi këto japin efekt serik lidhur me realizimin e qëllimeve zhvillimore.

3. KUPTIMI DHE LLOJET E RISKUT TË PROJEKTEVE

Risku mund të definohet si një ngjarje që mund të ndodh në të ardhmen dhe po ashtu si pasiguri me probabilitet të panjohur për ngjarjet e së ardhmes. Pasiguria e matur është risk. Zakonisht të dy termet pasiguri dhe rrezik në ekonomi shpesh përdoren si sinonime pasi në ekonomi nuk është e mundur që të përsëriten të njëjtat ngjarje saktësisht në të njëjtat rrethana. Kështu nga kjo mund të thuhet se është e vështirë të bëhet matja e rrezikut dhe vlerësimi i probabilitetit të ngjarjeve është vlerësim shumë subjektiv. Kështu risku i projektit mund të definohet si efekt kumulativ i shansit që dukuritë e pasigurta të ndodhin, efekt i cili do të ndikoj negativisht në objektivat e projektit. Pra kjo paraqet një shkallë të ekspozimit ndaj ngjarjeve negative dhe pasojave të mundshme që vinë nga këto ngjarje. Në përgjithësi, risku i projekteve karakterizohet nga tre faktorë:

- Ngjarja e riskut - Probabilitetit dhe - Shuma në rrezik Shumë autorë e definojnë apo klasifikojnë riskun e projektit nga aspekte të ndryshme. Në të shumtën e rasteve klasifikimin e riskut e shohim në bazë të raportit të tij me objektivat e projektit. Llojet me të shpeshta të riskut të cilat mund ti hasim janë:

- Risku i lidhur me kohën – ky lloj i rrezikut është i lidhur me kohën e objektivave të projektit duke u përpjekur për të shmangur vonesat.

- Risku financiar – ky lloj i rrezikut i referohet çmimit të objektivave të projektit duke u përpjekur që të mos kalohet buxheti i planifikuar. - Risku i kualitetit – është i lidhur me objektivat e arritjes së një performance të përshtatshme në projekt.

Përveç ndarjes të cilën e bëmë me lartë, risku i projekteve mund të ndahet apo të kategorizohet edhe sipas mënyrës se ndikimit të tij në objektivat e projektit. Në këtë kategori, të njohura janë dy lloje të riskut:

1. Risku indirekt apo i nënshtruar dhe

2. Risku direkt apo superior Risku indirekt është lloji i parë i riskut që mund të ndodh gjatë një projekti dhe konkretizimi i tyre shkakton shfaqjen riskut direkt. Kështu lidhja në mes të riskut indirekt dhe riskut direkt mund të përshkruhet si lidhje shkaktare-rrjedhimore.

Risku direkt është me superior në krahasim me atë indirekt pasi ky i fundit është vetëm shkaktar i riskut direkt duke shkaktuar probleme reale në projekt, të tilla si vonesat, tejkalim i buxhetit apo performancë joadekuate. Pra risku në projekt mund të paraqitet në forma të ndryshme dhe ndikimi negativ i tij mund të jetë i madh apo fatal për një projekt. Siç e kemi përmendur edhe më herët karakteristikë e projekteve është edhe prania konstante e riskut, prandaj është shumë e rëndësishme për një ndërmarrje, apo për menaxheret e saj që të bëjnë një vlerësim të riskut dhe përafrim të tij, ashtu që projekti të përfundoj me sukses dhe brenda kufijve të përcaktuar kohorë dhe financiar.

4. NË ÇFARË BAZE PROJEKTET DALLOHEN NGA AKTIVITETET E TJERA NË BIZNES?

Punët rutinore të cilat përsëriten dhe realizohen sipas modelit të dhënë më parë NUK JANË projekte. Shembuj të punëve rutinore të cilat nuk janë projekte janë p.sh: Shkrimi i raportit mujor, zgjidhja e lëndëve juridike, mentorimi i punimeve nga profesori, pagesa e faturave etj. Prandaj mund të konstatohet që projekte janë punët të cilat kanë një kohëzgjatje të përcaktuar më parë e që nuk janë pjesë e aktiviteteve të përditshme. Shembuj të projekteve janë: Organizimi i një eventi, ndërtimi i një objekti, ndërtimi i një punimi diplome nga studenti, regjistrimet me qëllim të

caktuar etj. Për realizim të suksesshëm para secilit projekt duhet pasur parasysh: - Duhet që para secilit projekt mirë të mendohet në lidhje me rolet e njerëzve të caktuar në projekt. - Ekziston një numër i madh i punonjësve të cilët kanë punuar në projekte të ndryshme. - Poashtu ekzistojnë njohuri të cilat mund t'u ndihmojnë atyre në projektet e ardhshme t'i punojnë dhe udhëheqin më lehtë dhe më suksesshëm. - Njohuritë nuk merren vetëm gjatë arsimit formal, por edhe me përvojë praktike, nëpërmes projekteve të suksesshëm dhe të pasuksesshëm. Nganjëherë edhe në gabime mund të mësohet. - Nevojiten njohuritë dhe përvoja në menaxhimin dhe organizimin e projekteve edhe për gjetjen e resurseve të nevojshme për realizimin e suksesshëm të projektit, p.sh., në rastet e paraqitjes së konkurseve për përkrahje të projekteve.

5. RESURSET NË PROJEKT

Resurset e projektit janë të gjitha ato që përdoren në projekt për të realizuar qëllimin e dëshiruar. Në resurse të projektit hyjnë: Njërëzit, Mjetet (materiale, jomateriale, financiare). Kohëzgjatja (koha) etj. Projekti nuk mund të realizohet suksesshëm në qoftë se resurset nuk janë të siguruar ose të disponueshme kur për ato ka nevojë! Për secilin projekt janë të rëndësishme resurset në vijim:

- Resurset e personelit dhe kohës,
- Resurset materiale dhe financiare, dhe eventualisht
- Këshillat dhe resurset për vazhdimet e mëtejme.

Identifikimi i resurseve për një projekt duhet të vlerësohet kur caktohen detyrat. Më tutje, duhet të ketë siguri që ato resurse do të jenë në dispozicion në kohën e kërkuar në mënyrë që projekti të realizohet sipas hapave/fazave të planifikuara. Planifikimi i resurseve nënkupton që për detyrat brenda projektit duhet të ndahen personeli, pajisjet materiale dhe fondet e nevojshme – sipas një vlerësimi të arsyeshëm e real. Projekti duhet të funksionojë brenda mjeteve ekzistuese dhe për resurset që do të përdoren në - 33 - mënyrë sa me efektive e efikase të mundshme me qëllim të realizimit të projektit me buxhet më të ulët, duke siguruar resurse për ndonjë projekt të ardhshëm.

6. PËRFUNDIM

Ndërsa “Menaxhimi i Projektit” përshkruhet si art dhe shkencë, që lidhet me konceptimin, planifikimin, projektimin, zbatimin dhe kontrollin e punës, në të gjitha fazat e projektit, i ndarë sipas ciklit të jetës së projektit, me qëllim të ofrimit të një produkti ose shërbimi. Përgjigje me e saktë ose definimi me i thjeshtë i Menaxhimit të Projektit do të ishte vetëm kombinimi i këtyre dy koncepteve ashtu që, “Projekti” përcakton kuadrin për objektivat e vendosura, rezultatet e pritshme dhe burimet e nevojshme ndërsa “Menaxhimi” përmbledh arritjen e objektiveve, ndjekjen e ecurisë së punës gjatë fazave të ndryshme, organizon dhe bënë ndarjen e detyrave. Pra menaxhimi i projektit është vetëm një mjet apo një listë metodash të cilat na ndihmojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektiveve tona.

Menaxhimi bashkëkohor i projekteve integron një sërë konceptesh të fuqishme të cilat procesin e qeverisjes e shndërrojnë në një proces të zgjedhjes së suksesshme të problemeve që ndërlidhen me ciklin që formësohet gjatë konceptimit dhe realizimit të projektit. Këto probleme janë të ndërlidhura me aspektet që përcaktojnë efikasitetin e projektit, e kjo pastaj ndërlidhet me efektet, shpenzimet, rrezikun, pasigurinë që e përcjellin projektin. Në këtë aspekt rëndësi të madhe parësore ka identifikimi i problemeve potenciale që mund të rrezikojnë realizimin e qëllimeve të projektit. Kështu, roli i menaxhmentit të projektit është që të minimizojë këtë rrezik.

LITERATURA

- Pinto, J.K., (2014). *Project Management Achieving Competitive Advantage*.
 Schwalbe, K. (2017). *An introduction to project management*.
 Meredith, J. R., Mantel, S.J. (2014). *Project Management a Managerial Approach, 8 Edition*.
 Kerzner, H. (2015). *Project Management 8 edition*.
 Klastorin, T., (2015). *Project Management*.
 Gido, J., & Klements, J.P. (2015). *Successful Project Management*.
 Kassel, D. S. (2014). *Managing Public sector projects*.
 Artto, K.A, Martubsuo, M., & Aalto, T. (2016). *Project Portfolio Management Strategic Management through Projects*.
 Richman, L. (2015). *Project Management the Managerial Process*.
 Wririck, D.W., (2015). *Public – Sector Project Management – meeting the Challenges and achieving results*.